

ENTI RREGULLATOR I UJIT



RAPORT

**Bilanci i Ujit i Shoqërive UK
(Viti 2020)**

Gusht, 2021

PËRMBAJTJA

Të Përgjithshme	3
1 Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.	4
Bilanci i ujit me komponentët përbërës të tij.....	6
1.1 Volumi i Ujit që Hyn në Sistem.....	6
1.2 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur	11
1.3 Uji Pa të Ardhura, Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale	15
Benchmarking i Bilancit të Ujit për vitin 2020, trendi dhe krahasimi me vitin paraardhës 2019.....	28
Benchmarking i Bilanceve të Ujit 2019-2020 për Sektorin	31
Rekomandime.....	32

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Bilanci i Ujit sipas IWA-s.....	5
Tabela 2 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i I-rë.....	7
Tabela 3 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i II-të.....	8
Tabela 4 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i III-të.....	9
Tabela 5 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes për Sektorin e Ujit.....	10
Tabela 6 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i I-rë	12
Tabela 7 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i II-të	13
Tabela 8 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të	14
Tabela 9 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur për Sektorin	14
Tabela 10 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i I-rë.....	18
Tabela 11 Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe Grupi i I-rë....	19
Tabela 12 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i II-të	22
Tabela 13 Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe Grupi i II-të ...	23
Tabela 14 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Paautorizuar- Grupi i III-të	24
Tabela 15 Konsumi i Faturuar Mesatar Ditor për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe Grupi i III-të ...	25
Tabela 16 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Paautorizuar- në Total	25
Tabela 17 Bilanci i Ujit për Sektorin për Vitin 2020 sipas IWA-s	26
Tabela 18 Bilanci i Ujit për Vitin 2020.....	27
Tabela 19 Krahasimi dhe trendi i komponentëve të bilancit të ujit- Grupi I-rë	28
Tabela 20 Krahasimi dhe trendi i komponentëve të bilancit të ujit- Grupi II-të	29
Tabela 21 Krahasimi dhe trendi i komponentëve të bilancit të ujit- Grupi III-të	30
Tabela 22 Krahasimi dhe trendi i komponentëve të bilancit të ujit në Total për Sektorin	31

Të Përgjithshme

“Bilanci i Ujit” është një instrument i rëndësishëm menaxhimi në veprimtarinë e çdo shoqërie Ujësjetllës Kanalizime. Gjatë hartimit të tij, çdo shoqëri përlllogarit dhe njihet me sasinë e ujit që hyn në sistemin e furnizimit, konsumin e autorizuar, humbjet administrative të shkaktuara nga lidhjet e paligjshme, nën faturimet, pasaktësitë gjatë vlerësimit dhe matjes së volumeve, si dhe humbjet fizike në të gjitha komponentët e sistemit të furnizimit me ujë.

Niveli i lartë i Ujit Pa të Ardhura, trendi në përkeqësim gjatë viti 2020, mbetet shqetësim për ERRU dhe në tërësi për Sektorin e ujit pasi rrezikon qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK si dhe cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Serioziteti i hartimit të Bilancit të Ujit, vlerësimi i komponentëve përbërës të tij sa më pranë vlerave reale, lidhet drejtpërsëdrejti me përcaktimin e nivelit real të Ujit Pa të Ardhura si dhe ndihmon çdo shoqëri UK për hartimin e planit të veprimeve, për marrjen e masave të domosdoshme për reduktimin e tij.

Edhe gjatë vitit 2020, në bilancet e dorëzuara pranë ERRU, vërehet se ende disa shoqëri paraqesin vështirësi, si në përcaktimin e komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, gjithashtu edhe në hartimin e tij në tërësi. Mungesa e matësive në pikat e prodhimit dhe për pasojë niveli i ulët i matjes për ujin e prodhuar, mbeten emergjente. Gabimi gjatë vlerësimit të sasive të prodhuara arrin në nivele të larta, kjo bën që dhe niveli i UPA t’i largohet nivelit real të tij.

Gjatë vendosjes së objektivave në procesin tarifor që ERRU vendos për të gjitha shoqëritë UK, në planin kryesor mbetet instalimi i ujëmatësve në prodhim dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve. Mungesa e matësive në pikat e kyçe të prodhimit dhe vlerësimi i gabuar i tij shpesh herë është shoqëruar me luhajtje të nivelit të UPA të pa argumentuara për disa shoqëri UK nga një vit në tjetrin.

Përpyqje për përmirësim të cilësisë së të dhënave të raportuara mbi Bilancin e Ujit shihet pothuaj nga të gjitha shoqëritë UK megjithatë ende ka shoqëri që të dhënat e raportuara mbi bilancin e ujit nuk përputhen me ato të raportuara në njësinë e Monitorimit e të Benchmarking pranë ERRU-së. Nga sa më sipër vërehet se Stafet Teknike të shoqërive kanë nevojë për trajnim mbi njohjen dhe përgatitjen e Bilancit të Ujit, përlllogaritjes së komponentëve përbërës, rrugët mbi zbulimin e lidhjeve të paligjshme si dhe mënyrat se si mund të përmirësohet niveli i UPA.

Për vitin 2020 nuk kanë raportuar të dhënat e kërkuara mbi Bilancet e Ujit shoqëritë UK Bulqizë, UK Pustec, UK Finiq dhe UK Kamëz. Të dhënat e paraqitura në këtë analizë për këto shoqëri janë marrë nga raportimi i tyre pranë njësisë së Monitorimit të ERRU-së, dhe jo si bilanc me vehte.

Sasia e ujit të prodhuar nga të gjitha shoqëritë UK është **309,887,138 m³**. Prodhimi total matet në nivelin 57%, ndërsa pjesa tjetër prej 43% vlerësohet. Mungesa e matësive në pikat kyçe të prodhimit të ujit mbetet akoma një problem i pazgjidhur.

Ndërkohë që Prodhimi Total u rrit me rreth 12.3 milion m³, Faturimi Total ka mbetur pothuaj i njëjtë me vitin e kaluar 2019. Nga totali i sasisë së ujit të faturuar, Faturimi i Matur zë 75.5% e tij, pjesa tjetër faturohet aforfe. Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar(1,639,962 m³) gjatë këtij viti paraqiti tendencë në përmirësim. Disa shoqëri raportojnë këtë konsum në nivele të pa justifikueshme, sasi të mëdha raportohen në larjet e depove dhe shuarjen e zjarreve ndonëse depot në përdorim apo numri i zjarreve të rëna kanë nevojë për volume më të vogla për finalizimin e këtyre proceseve.

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara për këtë vit treguan se **niveli i "Ujit Pa të Ardhura", i përkeqësuar me (-1.6%), aktualisht është 65.44%.**

Humbjet e përgjithshme, të përbëra nga Humbjet e Dukshme (administrative) dhe Humbjet Reale (fizike), janë 201,149,365 m³ ose 64.91% të ujit të prodhuar.

Humbjet administrative përbëjnë mesatarisht 48.9% të humbjeve të përgjithshme, gjë që tregon se është imediate domosdoshmëria e menaxhimit më të mirë të shoqërive.

Krahasuar me vitin 2019, niveli i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje paraqet tendencë në përmirësim, por që është në vlera të papranueshme dhe i mbivlerësuar. Procesi i eliminimit të tyre duhet të jetë në fokusin e çdo shoqërie pasi ato të vlerësuara nga raportimet përfaqësojnë 62.2% të humbjeve administrative ose 20% të prodhimit vjetor.

Elemente përbërës të humbjeve administrative janë edhe humbjet e shkaktuara nga nën faturimi i klientëve me matje me anë të komprometimit të faturuesve, nga lidhjet jo legale dyfishe, by-pass i matësit, nga mbi konsumi i klientëve me shtëpi private në zonën urbane dhe rurale që shpërdorojnë ujin për vaditje e që faturohen aforfe, si dhe nga pasaktësitë në matje për ujin e prodhuar e faturuar. Kërkohet vëmendje dhe angazhim më i madh i shoqërive për zvogëlimin dhe eliminimin e tyre si dhe pajisjen me ujëmatës sa më parë të të gjithë klientëve, si dhe në pikat kyçe të sistemit të furnizimit.

Gjatë analizës shoqëritë janë ndarë në tre grupe, bazuar kjo në numrin e lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë. Detaje të problematikave mbi Bilancin e Ujit jepen në analizën e mëposhtme.

1 Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.

Bilanci i Ujit për sektorin e ujësjellës kanalizimeve hartohet duke respektuar formatin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjetësve (IWA). Qëllimi kryesor në respektimin e këtij formati është unifikimi i metodologjisë dhe terminologjisë për të gjithë shoqëritë UK duke i vendosur ato në të njëjtat kushte vlerësimi për secilin nga komponentët e bilancit të ujit.

Bilanci i Ujit bazohet në të dhënat e plotësuara nga vetë stafi i shoqërive UK. ERRU realizon monitorimin e të dhënave të paraqitura dhe i përdor ato për përcaktimin e objektivave për reduktimin e humbjeve gjatë aplikimeve për nivele të reja tarifore.

Sipas vendimit të KKRR (nr.46, datë 27.12.2013), çdo shoqëri UK ka detyrimin të dorëzojë bilancin e ujit pranë ERRU një herë në 6 muaj. Aktualisht të gjitha shoqëritë UK janë në kushtet që nuk mund të përcaktojnë në mënyrë analitike komponentët e Humbjeve Reale, përkatësisht rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes, rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e lidhjes dhe rrjedhjet në depot e sistemit. Ndonjë tentativë mund të bëhet nga disa shoqëri për të matur humbjet nga rrjedhjet në rezervuarë, por ato janë pak të besueshme.

Në Tabelën 1 paraqiten komponentët përbërëse të Bilancit të Ujit të cilat llogariten duke u bazuar në të dhënat e grupuara vjetore nga çdo shoqëri UK.

Metodika e hartimit të bilancit të përdorur nga të gjitha shoqëritë në vendin tonë është ajo “lart-poshtë” (top-down), e cila fillon llogaritjet e të gjithë komponentëve të saj nga sipër, pra nga Konsumi i Autorizuar i ujit dhe më tej vazhdon me llogaritjen e Humbjeve të Dukshme ose Humbjeve Administrative. Me deduksion më tej përcaktohen Humbjet Reale ose Humbjet Fizike.

Këto janë edhe arsyt kryesore që aktualisht për hartimin e bilancit të ujit nga shoqëritë UK nuk mund të përdoret metoda nga “poshtë lart” (down-top) që përdoret gjerësisht nga shoqëritë e ujësjellësve të përparuara që kanë rrjete inxhinierike me matje, si dhe disponojnë teknologjinë e duhur të monitorimit dhe kontrollit që përdoret për përcaktimin e humbjeve.

Tabela 1 Bilanci i Ujit sipas IWA-s

Uji Prodhuar nga Burimet e Veta	Volumi i Ujit që Hyn në Sistem	Konsumi i Autorizuar	Konsumi i Autorizuar, i Faturuar	Uji i eksportuar		Uji me të Ardhura
				Konsum i matur	Konsum i pamatur	
Uji	Eksportuar (i blerë)	Humbjet e Ujit	Konsum i Autorizuar, i Pafaturuar	Konsum i matur		Uji Pa të Ardhura
				Konsum i pamatur		
			Humbjet Administrative	Konsum i paautorizuar		
				Pasaktësia në ujëmatëse		
				Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave		
			Humbjet Teknike		Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes	
Rrjedhjet dhe derdhjet në depot e Shoqërive						
		Rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e matjes				

1. Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij

1.1 Volumi i Ujit që Hyn në Sistem

Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit konsiderohet sasia e ujit të prodhuar në një vit kalendarik plus sasinë e ujit të blerë me shumicë nga operatorët e tjerë.

Matja apo vlerësimi i saktë i volumit të prodhuar është faktori kryesor përcaktues në nivelin real të treguesit UPA, për këtë arsye ky volum duhet të matet nga operatori me anë të ujëmatësve që instalohen në burim, në kaptazhe, puse, veprat e marrjes nga basenet sipërfaqësorë, si dhe në dalje të stacioneve qendrore të pompimit.

Leximet apo vlerësimet e volumeve ditore dhe mujore duhet të mbahen nga shoqëria në regjistrat përkatës. Në rastet kur nuk ka ujëmatës në prodhim, për të eliminuar pasaktësitë e mëdha në vlerësimin e volumit të ujit të prodhuar, prurjet e prodhuara duhet të vlerësohen bazuar në të dhënat e targetet e pompave, regjimin e punës, si dhe numrin e orëve të punës së tyre. Në rastin e kaptazheve vlerësimi i prurjes së prodhuar duhet të bëhet me instrumenta të thjeshtë që mund të ndërtohen në vend si kapërderdhës të formave trekëndësh ose kënddrejtë.

Pavarësisht udhëzimeve të dhëna nga ERRU, mjaft operatorë nuk zbatojnë siç duhet procedurat e vlerësimit të volumeve sipas rekomandimeve teknike, për pasojë niveli i humbjeve luhatet në nivele të ndryshme nga një vit në tjetrin pa treguar vlerën dhe tendencën reale të treguesit UPA, fenomen i shfaqur më shumë në shoqëritë e Grupit të II-të dhe të III-të.

Grupi i I-rë (me më shumë se 15,000 lidhje uji)

Gjatë analizës për Grupin e I-rë (14 shoqëri) rezultoi se për vitin 2020 të gjitha shoqëritë së bashku kanë prodhuar **253,202,366 m³ ujë** ose 4.5% më shumë se vitin e kaluar. Niveli i matjes për ujin e prodhuar ka pësuar rritje me rreth 6%. ***Aktualisht, në këtë grup vetëm 64% e volumit të ujit të prodhuar rezulton i matur, dhe vetëm 6 shoqëri nga ky grup arrijnë të matin 100% të sasisë së ujit të prodhuar.***

Krahasuar me të dhënat e tre viteve të fundit, variabëli “Ujë i Prodhuar” është rritur me 39 milion m³ ndërkohë që niveli i matjes është pothuaj i njëjti. Shoqëritë duhet të tregojnë kujdes që prodhimi vjetor të bazohet në kërkesën për ujë të parashikuar në planin e biznesit të hartuar prej tyre. Gjithashtu vërehet se shoqëritë nuk zëvendësojnë në kohën e duhur matësit që dalin nga puna me justifikimin e pamundësisë financiare.

Tabela 2 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për grupin e I-rë në zonën e shërbimit.

Tabela 2. Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i I-rë

Nr.	Operatorët UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m ³)	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
					(litra/dite, banor)	(m ³)	(%)
1	Tiranë UK	842,103	812,076	93,218,337	314	62,425,665	67%
2	Durrës UK	357,022	335,897	42,646,549	348	42,646,549	100%
3	Vlora UK	200,574	181,526	25,188,726	380	22,422,788	89%
4	Elbasan UK	212,628	155,046	16,809,000	297	0	0%
5	Fier UK	197,200	124,600	18,710,906	411	0	0%
6	Shkodër UK	208,618	115,906	13,122,350	310	0	0%
7	Korçë UK	130,114	117,354	4,036,190	94	4,036,190	100%
8	Berat Kuçovë UK	155,004	109,499	9,967,145	249	1,048,612	11%
9	Kavajë UK	84,250	81,304	6,073,000	205	6,073,000	100%
10	Lushnje UK	123,300	92,084	6,205,430	185	6,205,430	100%
11	Sarandë UK	57,800	62,700	4,172,333	182	4,172,333	100%
12	Kamëz UK	137,886	65,880	7,682,400	319	7,682,400	100%
13	Lezhë UK	89,737	64,795	2,982,000	126	2,087,400	70%
14	Pogradec UK	92,728	79,509	2,388,000	82	2,132,000	89%
Total		2,888,964	2,398,176	253,202,366	289	160,931,967	64%

Nga Tabela e mësipërme konstatohet:

- *Mbulimi me shërbim arrin të kryhet për 83% e popullsisë.*
- *Sasia e ujit e prodhuar (litra/ditë, banor) përgjithësisht është e mjaftueshme për një furnizim normal me ujë të konsumatorëve. **Paradoksalisht shoqëritë që kanë një rregjim furnizimi me ujë të popullsisë 24/7 (Korça dhe Pogradeci) kanë sasinë më të vogël të prodhimit të ujit për banor se sa shoqëritë e tjera që furnizojnë me ujë me rregjim të kufizuar.** Kjo do të thotë që këto të fundit duhet patjetër të përmirësojnë menaxhimin si dhe të rrisin përpjekjet për realizimin e nevojave për investime fizike në sisteme.*
- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, lidhur me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 24/7 në këto shoqëri, nuk duhet të bazohet në rritjen e volumit të prodhuar, por me reduktimin e humbjeve totale.*
- *Trendi në përmirësim i nivelit të matjes për ujin e prodhuar, vërehet në disa prej shoqërive UK. Mungesa e matësave në prodhim dhe mos zëvendësimi i tyre në rast defektesh vërehet pothuaj në gjysmën e shoqërive të grupit të parë.*

Grupi i II-të (me 3,000 deri 15,000 lidhje uji)

Gjatë vitit 2020, UK Poliçan dhe UK Tropojë iu bashkëngjitën **Grupit të II-të** të shoqërive pasi kaluan pragun e 3000 lidhjeve me ujin. Të gjitha shoqëritë në këtë grup prodhuan **52,047,318 m³** ujë ose rreth 2.33 milion

m³ më shumë se në vitin 2019. Niveli i matjes për ujin e prodhuar në burim, i përkeqësuar me 5%, është në nivele të ulta, **aktualisht shoqëritë e Grupit të II-të arrijnë të matin vetëm rreth 20% të prodhimit.**

Krahasuar me të dhënat e vitit 2019, vetëm katër shoqëri nga ky grup arrijnë të masin 100% të prodhimit të ujit. Përkeqësim i treguesit vërehet në shoqëritë UK Devoll, UK Cërrik, UK Roskovec, etj. Më shumë se gjysma e shoqërive në këtë grup nuk kanë të instaluar matësa në asnjë nga burimet e shfrytëzueshme për furnizimin me ujë.

Tabela 3 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për Grupin e II-të në zonën e shërbimit.

Tabela 3 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i II-të

Nr.	Operatoret UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m ³)	Ujë i Prodhuar (litra/ditë, banor)	Volumi i matur (m ³)	Uji i Prodhuar i Matur ne %
1	Maliq	63,383	41,481	1,178,762	78	0	0%
2	Gjirokastrë	51,875	51,875	3,272,776	173	0	0%
3	Devoll	41,493	39,231	1,218,611	85	585,897	48%
4	Dibër	78,000	31,000	3,400,000	300	0	0%
5	Cërrik	51,582	30,292	2,595,693	235	92,200	4%
6	Belsh	32,658	31,143	1,153,000	101	0	0%
7	Kurbin	66,458	30,678	2,394,143	214	24,752	1%
8	Kukës	47,963	35,845	1,837,640	140	0	0%
9	Librazhd	77,059	22,029	1,507,820	188	0	0%
10	Mat	38,400	31,680	1,785,000	154	0	0%
11	Divjake	55,250	30,350	1,296,169	117	924,169	71%
12	Kruje	80,807	35,140	2,506,303	195	2,506,303	100%
13	Himare	25,831	23,615	1,710,600	198	0	0%
14	Patos	43,715	31,897	2,826,000	243	0	0%
15	Mallakastër	41,378	32,020	1,730,000	148	1,180,000	68%
16	Gramsh	25,950	23,242	1,177,650	139	0	0%
17	Rrogozhine	42,570	28,070	928,000	91	928,000	100%
18	Bulqize	38,830	21,635	2,040,000	258	0	0%
19	Malësi e Madhe	50,414	32,600	1,814,000	152	86,000	5%
20	Tepelene	35,573	19,588	714,500	100	655,000	92%
21	Përmet	19,872	19,022	727,465	105	0	0%
22	Dropull	22,278	22,278	1,393,500	171	0	0%
23	Vore	39,592	19,350	1,814,000	257	86,000	5%
24	Selenice	18,485	13,736	2,692,000	537	0	0%
25	Kolonje	15,150	15,150	331,000	60	331,000	100%
26	Ura Vajgurore	39,991	20,315	1,190,776	161	0	0%
27	Peqin	39,260	25,060	1,856,000	203	1,412,522	76%
28	Tropoje	28,010	15,621	1,002,500	176	1,002,500	100%
29	Vau Dejës	51,724	29,593	829,000	77	465,000	56%
30	Skrapar	16,245	15,106	523,000	95	0	0%
31	Roskovec	32,720	16,374	931,990	156	0	0%
32	Delvine	18,837	16,783	461,020	75	0	0%
33	Mirdite	37,499	20,608	744,000	99	0	0%
34	Polican	17,271	11,864	464,400	107	0	0%
	Total	1,386,123	884,271	52,047,318	161	10,279,343	20%

Nga Tabela e mësipërme konstatohet që:

- *Mbulimi me shërbim arrin të kryhet vetëm për 64% të popullsisë në juridiksion.*
- *Përgjithësisht sasia e ujit e prodhuar (litra/ditë, banor) është e mjaftueshme për një furnizim normal me ujë të konsumatorëve. Për furnizimin me ujë pa ndërprerje (24/7), shoqëritë UK Maliq, UK Vau*

Dejës, UK Delvinë dhe UK Kolonjë duhet të verifikojnë kapacitetin aktual të burimeve. Nëse ato janë të pamjaftueshëm të shihen mundësitë për shfrytëzimin e burimeve të reja. **Devolli (si Korça dhe Pogradeci)** pavarësisht normës së ulët të prodhimit të ujit ofron një rregjim furnizimi me ujë për popullsinë pa ndërprerje.

- *Shumica e shoqërive disponojnë kapacitete të mjaftueshme për furnizimin pa ndërprerje të popullsisë. Nevojitet reduktimi i UPA, investime të reja si dhe menaxhim më i mirë nga stafet drejtuese e teknike të shoqërive.*

Grupi i III-të (me më pak se 3,000 lidhje uji)

Sasia e ujit të prodhuar nga **shoqëritë e Grupit të III-të** është **4,637,454 m³** ose 30% më pak se një vit më parë, kjo si pasojë e largimit të shoqërive UK Tropojë dhe Poliçan duke kaluar në Grupin e II-të. Uji i prodhuar aktualisht matet në nivelin 23%, disa nga shoqëritë kanë nivel mjaft të ulët të matjes ndërkohë që përkeqësim të tij paraqitën shoqëritë UK Këlcyrë dhe UK Konispol.

ERRU prej vitesh insiston dhe nxit shoqëritë e të gjitha grupeve, në sigurimin e fondeve për instalimin e matësave në burim me fondet e veta ose me ndihmen e Bashkive respektive, në mënyrë që të gjitha shoqëritë të kenë mundësinë të kontrollojnë sasinë e ujit të prodhuar që të jetë sa më afër nevojave për ujë. Gjithashtu, prodhimi i matur në nivele të larta ju krijon mundësinë shoqërive për të përlllogaritur sa më afër realitetit nivelin e UPA.

Tabela 4 jep prodhimin e ujit dhe nivelin e matjes së tij për grupin e III-të në zonën e shërbimit.

Tabela 4 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes - Grupi i III-të

Nr.	Operatoret UK	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m ³)	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
					(litra/ditë, banor)	(m ³)	(%)
1	Finiq	35,216	15,600	1,083,000	190	125,020	12%
2	Konispol	13,705	13,005	458,890	97	284,756	62%
3	Klos	20,578	6,480	210,720	89	42,270	20%
4	Puke	15,627	6,129	343,824	154	95,732	28%
5	Këlcyrë	12,389	5,788	294,000	139	161,000	55%
6	Has	13,448	9,326	832,820	245	250,717	30%
7	Libohove	7,200	7,200	1,030,000	392	9,000	1%
8	Fushë Arrëz	11,000	4,800	260,200	149	67,000	26%
9	Pustec	5,180	2,680	124,000	127	50,060	40%
Total		134,343	71,008	4,637,454	179	1,085,555	23%

Nga Tabela e mësipërme konstatohet që:

- *Mbulimi me shërbim arrin të kryhet për 53% të popullsisë në juridiksion.*

- *Përgjithësisht sasia e ujit e prodhuar (litra/ditë, banor) është e mjaftueshme për një furnizim normal me ujë të konsumatorëve.*
- *Problemi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë me ndërprerje qëndron në nivelin e madh të humbjeve të përgjithshme, reduktimi i të cilave me ruajtjen e së njëjtës sasi prodhimi do të sjellë rritjen e kohës së furnizimit me ujë për konsumatorët.*
- *Shoqëritë ndonëse kanë bërë përpjekje për të rritur nivelin e matjes, përsëri për vitin 2020 sasia e ujit të matur është në nivele të ulta. Mungesa e matësave në prodhim, pamundësitë financiare për instalimin apo zëvendësimin e tyre në rast defektesh mbetet faktor në luhatjen dhe nivelin e ulët të matjes për ujin e prodhuar si dhe përcaktimin real të nivelit të humbjeve në grup.*

Në mënyrë të përmbledhur gjendja e sektorit në lidhje me volumin e ujit të prodhuar dhe nivelin e matur të tij jepet në Tabela 5.

Tabela 5 Uji i Prodhuar dhe Niveli Matjes për Sektorin e Ujit

Grupet UK sipas lidhjeve	Popullsia në zonën e shërbimit	Popullsia me shërbim	Ujë i Prodhuar (m ³)	Ujë i Prodhuar	Volumi i matur	Uji i Prodhuar i Matur
				(litra/ditë, banor)	(m ³)	(%)
Grupi I-rë	2,888,964	2,398,176	253,202,366	289	160,931,967	64%
Grupi II-të	1,386,123	884,271	52,047,318	161	15,435,294	30%
Grupi III-të	134,343	71,008	4,637,454	179	1,085,555	23%
Total	4,409,430	3,353,455	309,887,138	253	177,452,816	57%

Të dhënat në tabelën e mësipërme tregojnë se gjatë vitit 2020,

- “Mbulimi me ujë” në sektor realizohet për **76%** të popullsisë në juridiksion.
- Shoqëritë UK kanë prodhuar **309,886,738 m³** ujë, nga të cilat 57% raportohet i matur dhe 43% e tij i vlerësuar.
- Prodhimi i ujit litra/ditë, për banor përgjithësisht është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë 24/7 të banorëve, emergjente mbetet reduktimi i Ujit Pa të Ardhura. Paraqiten e nevojshme rritja e sasisë së ujit të prodhuar (burime të reja) për shoqëritë **UK Maliq, UK Vau Dejës, UK Delvinë dhe UK Kolonjë**, si kusht i domosdoshëm për arritjen e objektivit të furnizimit me ujë 24/7 të popullsisë.

Si konkluzion

- *Gjithsesi të dhënat e raportuara mbi volumin e ujit të prodhuar në burim duhen marrë me rezervë, instalimi me matës të mëdhenj në të gjitha burimet e shfrytëzueshme është i domosdoshëm.*

- *Monitorimi i vlerësimit të prurjeve në ato sisteme që nuk kanë matës në burim duhet të jetë prioritet i shoqërive UK në mënyrë që të kemi një bazë vlerësimi të treguesit të Ujit Pa të Ardhura sa më afër realitetit.*
- *Pajisja me matësa e pikave të prodhimit të ujit është e rëndësishme për të gjitha shoqëritë UK. Niveli i matjes për ujin e prodhuar nga shoqëritë e Grupit të II-të e të III-të akoma shënon vlera jo të kënaqshme. Shoqëritë e Grupit të I-rë të cilët arrijnë të prodhojnë rreth 82% të ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes e kanë edhe me emergjente përmirësimin e nivelit të matjes. Problem paraqesin UK Elbasan, UK Shkodër, UK Fier, UK Berat-Kuçovë dhe UK Tiranë, për të cilat mungesa e matësave në prodhim është e pa justifikueshme.*
- *Sasia e ujit e prodhuar, për disa nga shoqëritë e Grupit të II-të, është e pamjaftueshme për furnizimin e popullatës. Për rritjen e cilësisë së shërbimeve me synimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje (24/7) kërkohet rritja e sasisë së ujit të prodhuar dhe ndoshta gjetja e burimeve të reja të ujit për shoqëritë **UK Maliq, UK Vau Dejës, UK Delvinë dhe UK Kolonjë.***

1.2 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur

Konsumi i autorizuar është volumi i ujit të matur dhe të pamatur që merret nga konsumatorët për përdorim vetjak, komerciale, industriale me bazë kontrate që ky konsumator ka me shoqërinë UK.

Grupi i I-rë

Për vitin 2020, shoqëritë e Grupit të I-rë raportuan **Konsumin e Autorizuar Total** në nivelin **82,050,039 m³**.

Konsumi i Autorizuar i Faturuar përbën 98,5% e Konsumit Total të Autorizuar. Krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar, Konsumi i Faturuar i Matur në nivelin 80% është përmirësuar me (+3%), ku shoqëritë UK Sarandë, UK Durrës, UK Fier, UK Shkodër kanë rritur numrin e lidhjeve të ujit me matës.

Me nivel të ulët të matjes paraqiten UK Vlorë (47%) dhe UK Fier (54%).

Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar (nevoja vetjake të shoqërisë, larje depush, zjarrfikës etj) përbën 1.5% të Konsumit Total të Autorizuar. Gjate këtij viti, ky konsum i reduktuar me rreth 26% në rang grupi, paraqitet në nivelin **1,201,074 m³** dhe është totalisht i vlerësuar. Asnjë nga shoqëritë nuk ka instaluar matësa në asnjë nga klientët për të cilët është vendosur që ky konsum të falet.

Detaje për Konsumin e Autorizuar të Matur dhe të Pamatur të ujit për Grupin e I-rë jepen në Tabelën 6.

Tabela 6 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i I-rë

Nr.	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matjete %	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa Faturuar me matjete %
		Totali (m ³)	I matur (m ³)	Aforfe (m ³)		Totali	I matur (m ³)	I vlerësuar	
1	Tiranë	35,941,521	31,337,081	4,604,440	87%	1,984	0	1,984	0%
2	Durrës	8,728,802	7,823,162	905,640	90%	0	0	0	0%
3	Vlore	5,538,196	2,595,857	2,942,339	47%	50,000	0	50,000	0%
4	Elbasan	4,324,000	3,086,000	1,238,000	71%	168,090	0	168,090	0%
5	Fier	4,538,802	2,466,367	2,072,435	54%	187,711	0	187,711	0%
6	Shkodër	3,960,605	2,198,092	1,762,513	55%	211,138	0	211,138	0%
7	Korçë	2,792,450	2,696,800	95,650	97%	530	0	530	0%
8	Berat Kuçovë	2,829,671	1,987,878	841,793	70%	445,578	0	445,578	0%
9	Kavajë	2,283,000	1,569,500	713,500	69%	15,100	0	15,100	0%
10	Lushnje	1,881,269	1,833,096	48,173	97%	2,930	0	2,930	0%
11	Kamëz	2,777,830	2,014,030	763,800	73%	69,888	0	69,888	0%
12	Sarandë	1,958,046	1,901,760	56,286	97%	27,362	0	27,362	0%
13	Lezhë	1,857,411	1,395,227	462,184	75%	4,263	0	4,263	0%
14	Pogradec	1,437,362	1,373,722	63,640	96%	16,500	0	16,500	0%
Total		80,848,965	64,278,572	16,570,393	80%	1,201,074	0	1,201,074	0%
Konsumi i Autorizuar në Total: 82,050,039 m³									

Grupi i II-të

Konsumi i Autorizuar në total, nga shoqëritë e Grupit të II-të, është **24,609,392 m³**. Ky konsum raportohet i matur në nivelin 64% të tij, ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Konsumi i Autorizuar i Faturuar përbën 98% të tij ndërsa ai i Pa Faturuar është rreth 2%. Vetëm shoqëritë UK Belsh dhe UK Devoll matin 100% këtë konsum.

Me nivelin më të ulët të matjes paraqiten UK Selenicë (8%), UK Bulqizë (25%), UK Kukës(30%), UK Gjirokastër (30%) dhe UK Kurbin (15%).

Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar në nivelin **2% (412,888 m³)** është pothuaj tërësisht i pamatur. Shoqëritë UK duhet të bëjnë kujdes gjatë vlerësimit të këtyre volumeve pasi sasi të e raportuara shpesh nuk përkojnë me volumet reale të përdorura për pastrimin e depove, shuarjen e zjarreve etj.

Detaje për Konsumin e Autorizuar të Matur dhe të Pamatur për grupin e II-të jepen në Tabelën 7.

Tabela 7 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i II-të

Nr.	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje ne %	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa faturuar me matje ne %
		Total (m3)	I matur (m³)	Aforfe (m3)		Totali	I matur (m³)	I vlerësuar	
1	Maliq	734,200	607,700	126,500	83%	15,009	0	15,009	0%
2	Gjirokaštër	2,377,056	702,378	1,674,678	30%	1,530	0	1,530	0%
3	Devoll	896,540	896,540	0	100%	5,400	0	5,400	0%
4	Dibër	1,402,200	908,400	493,800	65%	17,000	0	17,000	0%
5	Cërrik	722,568	603,741	118,827	84%	8,000	0	8,000	0%
6	Belsh	887,000	885,800	1,200	100%	450	0	450	0%
7	Kurbin	1,096,730	163,728	933,002	15%	15,750	0	15,750	0%
8	Kukës	1,203,000	359,573	843,427	30%	2,500	0	2,500	0%
9	Librazhd	713,467	704,530	8,937	99%	17,000	0	17,000	0%
10	Mat	965,300	627,385	337,915	65%	17,700	0	17,700	0%
11	Divjakë	924,169	902,259	21,910	98%	7,800	0	7,800	0%
12	Krujë	807,929	594,287	213,642	74%	5,063	0	5,063	0%
13	Himarë	430,000	419,500	10,500	98%	84,300	0	84,300	0%
14	Patos	1,222,929	948,693	274,236	78%	9,000	0	9,000	0%
15	Mallakastër	663,558	324,335	339,223	49%	30,200	0	30,200	0%
16	Gramsh	723,100	567,400	155,700	78%	1,000	0	1,000	0%
17	Rrogozhinë	350,000	311,400	38,600	89%	22,700	0	22,700	0%
18	Bulqizë	1,154,000	288,000	866,000	25%	0	0	0	0%
19	Malësi e Madhe	614,000	344,000	270,000	56%	8,000	0	8,000	0%
20	Tepelenë	469,264	339,263	130,001	72%	6,485	0	6,485	0%
21	Përmet	485,814	458,218	27,596	94%	7,980	0	7,980	0%
22	Dropull	359,850	294,850	65,000	82%	6,300	0	6,300	0%
23	Vorë	614,000	344,000	270,000	56%	8,000	0	8,000	0%
24	Selenicë	726,960	60,360	666,600	8%	5,200	0	5,200	0%
25	Kolonjë	252,230	111,870	140,360	44%	2,000	0	2,000	0%
26	Ura Vajgurore	494,500	450,700	43,800	91%	0	0	0	0%
27	Peqin	650,164	628,612	21,552	97%	21,575	275	21,300	1%
28	Tropojë	454,910	364,610	90,300	80%	0	0	0	0%
29	Vau Dejës	280,200	230,100	50,100	82%	47,500	0	47,500	0%
30	Skrapar	287,000	139,000	148,000	48%	12,000	0	12,000	0%
31	Roskovec	333,522	284,702	48,820	85%	4,086	0	4,086	0%
32	Delvinë	261,964	134,660	127,304	51%	3,360	0	3,360	0%
33	Mirditë	388,000	255,000	133,000	66%	20,000	0	20,000	0%
34	Poličan	250,380	179,700	70,680	72%	0	0	0	0%
Total		24,196,504	15,435,294	8,761,210	64%	412,888	275	412,613	0%
Konsumi i Autorizuar Total: 24,609,392 m³									

Grupi i III-të

Konsumi i Autorizuar total në Grupin e III-të është **2,078,342 m³** ujë. Konsumi i Autorizuar i Faturuar matet në nivelin 53%, pjesa tjetër faturohet aforfe. Vetëm 1% e sasisë së konsumit të autorizuar nuk faturohet, pasi përdoret nga shoqëritë për nevojat e tyre.

Me nivelin më të lartë të matjes paraqiten UK Konispol (98%) dhe UK Pustec (98%) ndërsa UK Libohovë (3%) performon me nivelin më të ulët të matjes në grup.

Konsumi i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të, në mënyrë të detajuar jepet në Tabela 8.

Tabela 8 Konsumin i Autorizuar i Ujit i Matur dhe i Pamatur Grupi i III-të

Nr.	Operatorët UK	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje ne %	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa Faturuar me matje ne %
		Total (m3)	I matur (m ³)	Aforfe (m3)		Totali	I matur (m ³)	I vlerësuar	
1	Finig	369,230	125,020	244,210	34%	0	0	0	0%
2	Konispol	291,776	284,756	7,020	98%	480	0	480	0%
3	Klos	162,070	42,270	119,800	26%	2,120	0	2,120	0%
4	Puke	187,278	95,732	91,546	51%	5,400	0	5,400	0%
5	Këlcyrë	198,000	161,000	37,000	81%	2,000	0	2,000	0%
6	Has	354,868	250,717	104,151	71%	8,000	0	8000	0%
7	Libohove	321,860	9,000	312,860	3%	0	0	0	0%
8	Fushë Arrëz	116,200	67,000	49,200	58%	8,000	0	8,000	0%
9	Pustec	51,060	50,060	1,000	98%	0	0	0	0%
Total		2,052,342	1,085,555	966,787	53%	26,000	0	26,000	0%
Konsumi i Autorizuar në Total 2,078,342 m ³									

Tabela 9 jep në mënyrë të përmblëdhur gjendja e sektorit në lidhje me Konsumin e Autorizuar të Matur dhe të Pamatur, si dhe Konsumin e Autorizuar të Pa Faturuar.

Tabela 9 Konsumi i Autorizuar i Matur dhe i Pamatur për Sektorin

Grupet	Konsumi i Autorizuar i Faturuar			Uji i Faturuar me Matje (%)	Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar			Uji i Pa Faturuar me Matje (%)
	Totali sipas Grupeve (m3)	I matur (m3)	I vlerësuar aforfe (m ³)		Total (m3)	I matur (m3)	I vlerësuar (m ³)	
Grupi I-re	80,848,965	64,278,572	16,570,393	80%	1,201,074	0	1,201,074	0%
Grupi II-të	24,196,504	15,435,294	8,761,210	64%	412,888	275	412,613	0%
Grupi III-të	2,052,342	1,085,555	966,787	53%	26,000	0	26,000	0%
Total	107,097,811	80,799,421	26,298,390	75%	1,639,962	275	1,639,687	0%
Konsumi i Autorizuar në Total: 108,737,773 m ³								

Sa më sipër vërehet:

- Gjatë vitit 2020, në lidhje me **Konsumin e Autorizuar** të gjitha shoqëritë UK kanë konsumuar **108,737,773 m³ujë**, **Konsumi i Autorizuar i Faturuar** është 98,5% i Konsumit të Autorizuar Total ndërsa **Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar** është në nivelin 1.5% të tij.
- Krahasuar me të dhënat e vitit 2019, niveli i matjes për **Konsumin e Faturuar** është përmirësuar me 2%, ku aktualisht ky konsum është në nivelin 75%. Nevoja për planifikimin për investime në ujëmatësia shihet pothuajse në të gjitha shoqëritë UK, faturimi i matur dhe korrekt është një e drejtë për të gjithë konsumatorët të cilët duhet të faturohen sipas sasisë reale të ujit që ato konsumojnë.

1.3 Uji Pa të Ardhura, Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale

Të Përgjithshme mbi Humbjet

Ujë Pa të Ardhura (UPA) konsiderohet vëllimi i ujit i prodhuar që nuk arrin t'ju faturohet klientëve, pra që nuk gjeneron të ardhura për shoqërinë e ujësjellësit. UPA përfaqëson diferencën mes vëllimit në hyrje (in put) të sistemit dhe Konsumit të Autorizuar të Faturuar. Theksohet fakti që ***vlerësimi i komponentëve të UPA-s është pjesa më e rëndësishme e Bilancit të Ujit që lidhet kryesisht me humbjet e përgjithshme të ujit në sistem.***

Humbjet e Ujit ose Humbjet e Përgjithshme përbëjnë diferencën ndërmjet vëllimit në hyrje të sistemit dhe Konsumit të Autorizuar (të faturuar dhe të pa faturuar) dhe përbëhet nga Humbjet e Dukshme dhe Humbjet Reale.

Humbjet e Dukshme ose Humbjet Administrative konsistojnë në Konsumin e Pa Autorizuar (vjedhje, nën faturime, lidhje ilegale), në pasaktësitë në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori, si dhe gabimet sistematike në trajtimin e të dhënave.

Në humbjet e dukshme, rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet konsumit të pa autorizuar i cili përbën pjesën dominuese të tyre. Elementët kryesorë të konsumit të pa autorizuar janë ***lidhje ilegale*** dhe ***nën faturimet*** e ndryshme.

Për ***lidhjet ilegale treguesi bazë për ekzistencën e një numri të konsiderueshëm të tyre është diferenca e evidente në data bazë ndërmjet numrit të popullsisë së shërbyer dhe numrin e kontratave që ka shoqëria me konsumatorët familjarë.*** Në këtë diferencë peshë të madhe mund të kenë edhe lidhjet dyfishe, prania e të cilave mund të evidentohet nga nivelet mjaft të ulëta të faturimeve për konsumatorët familjarë me matje.

Gjithsesi krahas evidentimeve në terren, evidentimi më i mirë dhe eliminimi i lidhjeve bëhet duke bashkërenduar planin e investimeve për tubacionet e vjetra me prioritet zonat ku dyshohet që ka prani të madhe të lidhjeve të paligjshme dhe të dyfishta, ***investime që krahas përmirësimit dhe ridimensionimit korrekt të tubacioneve, zbulojnë dhe eliminojnë automatikisht edhe lidhjet e paligjshme.***

Nën faturimi, si element i rëndësishëm në humbjet e dukshme, shkaktohet nga korruptimi i faturuesve të cilët nuk faturojnë sasinë reale të matur të ujit në konsumatorët me matje, si edhe prania e lidhjeve dyfishe ose by-pass i matësit. ***Ky fakt konstatohet kur vërehet normë mesatare konsumi në konsumatorët me matje nën vlerat historike apo mesatare të pritshme në ujësjellës të ngjashëm.*** Si normë mesatare vjetore konsumi mund të përdoret norma prej 80 litra/ditë, banor, bazuar kjo në eksperiencën e disa prej shoqërive me nivel 100% të matjes për kategorinë e konsumatorëve, si Korça dhe Pogradeci.

Për eliminimin e këtij fenomeni shoqëritë duhet të verifikojnë faturat e konsumatorëve me matje në vlera mjaft të ulëta që si shkak kanë probleme të leximit nga faturistët, probleme funksionimi i matësit ose by-pas i tij, apo lidhje dyfishe furnizimi me ujë. Zgjidhja më e mirë për eliminimin e problemit është pajisja me

matësa inteligjent e konsumatorëve, investim ky me kosto të lartë që kërkon mbështetjen donatorëve apo të Qeverisë Vendore, për disa nga shoqëritë UK.

Nën faturimet mund të ndodhin tek konsumatorët me faturim aforfe kryesisht ato të shtëpive private apo në zonat rurale që realizojnë mbi konsum të ujit për ujitje. Shoqëritë duhet të vlerësojnë këto raste dhe ti pajisin urgjentisht këta konsumatorë me matësa. Subjekt verifikimi duhet të jetë dhe numri i pjesëtarëve të familjes, për këtë shoqëritë duhet t'u kërkojnë klientëve të cilët faturohen aforfe të paraqesin një certifikatë të gjendjes familjare që vërteton numrin e saktë të tyre si subjekt i kontratës me shoqërinë UK.

Humbjet Reale ose Humbjet Fizike të ujit në sistemin e furnizimit me ujë përfshijnë të gjitha tipet e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, rrjedhjet e depove, rrjedhjet për shkak të riparimeve në sistem, në stacionin e pompave dhe në burimet e ujit.

Metoda e përdorur për hartimin e Bilancit të Ujit "lart-poshtë", presupozon që humbjet reale llogariten në fund si diferencë e ujit që hyn në sistem me shumën e të gjithë komponentëve të tjerë të bilancit, pra ujit të faturuar, konsumit të autorizuar të pa faturuar dhe humbjeve të dukshme (administrative).

Llogaritja e elementëve të humbjeve fizike (rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes, rrjedhjet e kapërderdhjet në depot e shoqërive, si dhe rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e matjes) janë të mundura nëse rrjetet shpërndarëse janë të ndara në zona të veçanta të pavarura (DMA) dhe me matje individuale të 100% të konsumatorëve. I vetmi komponent i mundshëm i humbjeve fizike që mund të llogaritet (matet) janë rrjedhjet në depo, por që së bashku me kapërderdhjet e mundshme ky komponent nuk duhet të kalojë vlerën 3% të sasisë së ujit që hyn në sistem. Nga ana tjetër sistemet e furnizimit me ujë në vendin tonë kanë një regjim furnizimi me ujë me ndërprerje, kështu që vlera absolute që përfaqësojnë humbjet fizike është fiktive është mjaft e ndryshme nga ato të regjimit të furnizimit pa ndërprerje .

Konceptimi dhe ndërtimi i rrjeteve shpërndarëse sipas DMA-ve është domosdoshmëri për vlerësimin dhe reduktimin e humbjeve për të realizuar dhe arritur më tej në regjimin e furnizimit me ujë 24/7 orë në ditë. Strategjia e realizimit të saj detyrimisht duhet të bëhet gradualisht hap pas hapi me zona pilot.

Grupi i I-rë

Gjatë vitit 2020, shoqëritë e Grupit të I-rë prodhuan **253,202,366 m³** ujë ndërsa faturuan **80,848,965 m³**. Krahasuar me një vit më parë, treguesi **UPA në nivelin 68.1%** u përkeqësua me (+2.1%), ndërkohë që prodhimi u rrit me (+11.3 milion m³), faturimi total pësoi rënie në nivelin 3%. ***Uji Pa të Ardhura në grup është në nivele të papranueshme, reduktimi i tij është sfida kryesore për këto shoqëri.***

Nevojën për reduktim të treguesit UPA paraqesin të gjitha shoqëritë. Shoqëri me nivele të kënaqshme të treguesit UPA paraqiten UK Korçë me 30.8%, UK Lezhë me 37.7% dhe UK Pogradec me 39,8%.

Me nivele mjaft të larta dhe të papranueshme të UPA vazhdojnë të paraqiten shoqëritë UK Durrës me 79.5%, UK Vlorë me 78%, UK Elbasan me 77%, UK Fier 75.7%, UK Kamëz 63.8%, UK Berat-Kuçovë 71.6% etj.

Uji Pa të Ardhura në grup është 173,047,631 m³, **Humbjet e Dukshme** në sasinë **85,306,725 m³**, përfaqësojnë 49.5% të UPA. Një pjesë e mirë e këtyre humbjeve shkaktohen nga prezenca e lidhjeve të paligjshme të raportuara në transmetim (25,867,762 m³) dhe shpërndarje (28,388,571 m³). Niveli i lartë i humbjeve nga lidhjet e paligjshme tregon mangësi në menaxhim e cila duhet përmirësuar nga të gjitha shoqëritë UK sidomos në zonat rurale.

Mjaft klientë nën faturohen si pasojë e korrupsionit të faturuesve nga disa klientë me matës. Ky fenomen spikat më tepër në klientë të zonave rurale me shtëpi private ku shpërdorimet e ujit për ujitje janë të mëdha, apo në klientë me biznese si hoteleri, restorante etj, ku konsumi shpesh herë faturohet si për klientë familjar.

Me nivele të larta, në drejtim të humbjeve të dukshme paraqiten shoqëritë, përkatësisht UK Shkodër 190.5 l/d, banor, UK Fier 187.8 l/d, banor, UK Vlorë 157.0 l/d, banor, UK Durrës 137.5 l/d, banor, etj.

Humbjet Reale të shkaktuara kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, në sasinë **85,845,602 m³**, përbëjnë 49.8% të UPA. Krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar rritja e tyre me rreth 20.7 milion m³ duhet marrë me rezerve pasi shumë shoqëri hasin vështirësi në hartimin e bilancit të ujit si dhe në përllogaritjen e komponentëve që përbëjnë atë.

Humbjet Reale, në litra/ditë, banor, paraqiten në nivele mjaft të larta për UK Durrës 139.1 l/d, banor, UK Vlorë 138.8 l/d, banor, UK Elbasan 111.4 l/d, banor, UK Tiranë 114.6 l/d, banor, UK Fier 119.7 l/d, banor etj.

Si përfundim gjatë vitit 2020, shoqëritë e Grupit të I-rë, kanë prodhuar 289 l/ditë, banor, kanë faturuar 92.4 l/ditë, banor dhe humbasin 198 l/ditë, banor.

Nëse regjimi i furnizimit me ujë do të ishte 24/7 orë, vlera absolute e humbjeve të shprehura në litra/ditë për banor do të ishte akoma më e madhe.

Tabela 10 jep një pasqyrë të plotë të Humbjeve të Dukshme dhe ato Reale, ndërsa në **Tabelën 11** jepen të dhëna mbi Konsumin Mesatar të Autorizuar me matje dhe aforfe të shprehura në litra/ditë, banor për Grupin e I-rë të shoqërive. Probleme me nën faturimin për klientët familjare me matje vërehet në shoqëritë UK Lushnje dhe UK Pogradec. Kjo është e evidente sidomos për Lushnjën sepse Pogradeci mund ta justifikojë normën si pasojë e një numri mjaft të madh të shtëpive të dyta të klientëve që nuk banojnë në mënyrë të përhershme në këtë qytet.

Konsumi i Autorizuar Mesatar aforfe i shprehur në litra/ditë, banor tregon për faturim nën vlerën e parashikuar nga VKM për faturimin aforfe, nga ndonjë anomali të mundshme të gabimit sistematik të sistemit që duhet korrigjuar. Probleme me faturimin aforfe që duhet verifikuar paraqesin shoqëritë UK Pogradec, UK Kavajë, UK Lushnje, UK Sarandë.

Tabela 10 UPA, Humbjet e Dukshme, Reale dhe nga Konsumi i Pa autorizuar- Grupi i I-rë

Nr.	Operatorët	Uji Pa të Ardhura (UPA)			Humbjet e Dukshme (Administrative)			Humbjet Reale (Fizike)			Humbjet nga Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar		
		(m³)	(%)	(litra/dite, banor)	(m³)	(%)	(litra/dite, banor)	(m³)	(%)	(litra/dite, banor)	(m3)	(%)	(litra/dite, banor)
1	Tirane	57,276,816	61.4%	193	23,309,641	41%	78.6	33,965,191	59%	114.6	1,984	0.00%	0.0
2	Durrës	33,917,747	79.5%	277	16,857,918	50%	137.5	17,059,829	50%	139.1	-	0.00%	0.0
3	Vlore	19,650,530	78.0%	297	10,401,500	53%	157.0	9,199,030	47%	138.8	50,000	0.25%	0.8
4	Elbasan	12,485,000	74.3%	221	6,010,820	48%	106.2	6,306,090	51%	111.4	168,090	1.35%	3.0
